



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

---

## OLIMPIADA NDËRKOMBËTARE E SHKENCAVE “ALIJA IZETBEGOVIÇ”

Bashkia e Çekmeceköy në Stamboll të Turqisë organizon për shtetasit turq dhe të huaj Konkursin Ndërkombëtar të Projekteve: “*Olimpiada Ndërkombëtare e Shkencave Alija Izetbegoviç*”. Ky konkurs ndërkombëtar synon të inkurajojë të rinjtë e së ardhmes, të cilët dëshirojnë të kontribuojnë për shkencën dhe zhvillimin e mendimit shkencor nëpërmjet veprimtarisë shkencore të nxënësve të shkollave të mesme.

Konkursi ndërkombëtar ka si objektiv:

- Të mbështesë bashkëpunimin ndërmjet shkollave të mesme në nivel ndërkombëtar.
- Të japë kontribut për bashkëpunim me komunitetet turke brenda dhe jashtë vendit.
- Të rrisë interesin e të rinjve në shkencë, kulturë, dhe art.

Në këtë konkurs do të prezantohen:

1. Projekte kërkimore;
2. Projekte në fushën e teknologjisë;
3. Projekte për energjinë e rinovueshme.

Vlerësimi nga juria do të bëhet mbi bazën e kriterëve të caktuar për: mënyrën e paraqitjes së projektit, metodës shkencore të përdorur, pritshmërinë, zbatimin dhe përfundimin.

Për detaje të tjera lidhur me materialet informativë, për kushtet e pjesëmarrjes dhe mënyrën e aplikimit *on line*, referojuni adresës së internetit :

[www.scienceturkey.com](http://www.scienceturkey.com);

## DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE